Në 45-vjetorin e rënies heroike të Tahir dhe Nebih Mehës, edhe Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka përkujtuar me nderim jetën, veprën dhe qëndresën e tyre të pavdekshme për liri dhe dinjitet kombëtar. “Sakrifica e familjes Meha mbetet një nga simbolet më të fuqishme të rezistencës shqiptare, frymëzim i përhershëm për brezat që luftuan dhe vazhdojnë ta duan atdheun me të njëjtin ideal”, thuhet në mesazhin e OVLUÇK-së.



## SHOQËRIA KOSOVARE NË DRITËN E HUMANIZMIT TË ERICH FROMM-it



Shkruan:  
Ibrahim GASHI

Erich Fromm ishte një nga mendimtarët më të rëndësishëm të shekullit XX i cili analizoi lidhjen mes psikologjisë njerëzore dhe strukturave shoqërore. Duke lexuar esetë mbi humanizmin, lirinë dhe krizën modern të përmbledhura në veprën e tij Humanismus in Krisenzeiten (“Humanizmi në kohë krizash”), gjejmë argumenti-

min me të mirë se si shoqëritë mund të hyjnë në gjendje “normaliteti patologjik”, ku pasiguria, frika dhe konformizmi bëhen pjesë e jetës së përditshme. Kjo qasje teorike ofron një perspektivë të vlefshme edhe për të kuptuar realitetin aktual të shoqërisë kosovare. Shoqëria kosovare po kalon një periudhë të ndërlikuar tranzicioni social, politik dhe kulturor. Megjithatë Kosova ka ndërtuar institucione demokratike dhe ka arritur

zhvillime të rëndësishme pas luftës, vazhdojnë të ekzistojnë pasiguri ekonomike, polarizim politik, emigrim i të rinjve dhe rënie e besimit në institucionet publike. Këto fenomene kanë krijuar një ndjenjë të përgjithshme lodhjeje dhe zhgënjimi kolektiv.

Nga perspektiva e Fromm-it, pasiguria e vazhdueshme prodhon ankth shoqëror dhe i shtyn individët të kërkojnë siguri psikologjike te grupet politike, ideologjitë ose figurat autoritare. Në Kosovë kjo reflektohet në militantizmin partiak, në ndarjet e forta “ne kundër atyre” dhe në mungesën e kulturës së dialogut racional. Debati publik shpesh dominohet nga emocione kolektive dhe jo nga analiza kritike e problemeve reale.

Një tjetër element i rëndësishëm në teorinë e Fromm-it është “narcizmi grupor”, ku grupi i vet konsiderohet superior ndërsa mendimi ndryshe shihet si kërcënim. Në kontekstin kosovar kjo mund të vërehet në polarizimin politik dhe social, si dhe në kulturën e sulmit ndaj kritikës, sidomos në rrjetet sociale. Kjo gjendje dobëson solidaritetin qytetar dhe pengon ndërtimin e një kulture demokratike të shëndetshme.

Po ashtu, Fromm kritikonte konformizmin modern dhe humbjen e individualitetit.

Edhe në Kosovë ekziston presion i madh social për përshtatje me normat e grupit, familjes ose opinionit publik. Shumë individë hezitojnë të shprehin mendime të pavarura nga frika e izolimit ose paragjykitimit. Kjo krijon një shoqëri ku autenticiteti shpesh sakrifkohet për praninë sociale. Në aspektin kulturor, ndikimi i konsumizmit dhe rrjeteve sociale ka forcuar kulturën e dukjes dhe të suksesit simbolik. Vlera e individit shpesh lidhet me statusin ekonomik ose imazhin publik, fenomen që Fromm e konsideronte si humbje të dimensionit human të jetës. Sipas tij, kur “të kesh” bëhet më e rëndësishme se “të jesh”, shoqëria rrezikon zbrazëti emocionale dhe dehumanizim.

Megjithatë, qasja e Fromm-it nuk është vetëm kritike, por edhe humaniste dhe shpresëdhënëse. Ai besonte se shoqëritë mund të dalin nga krizat përmes zhvillimit të mendimit kritik, edukimit humanist, solidaritetit dhe kulturës së dialogut.

Nëse do t'i kontekstualizonim mësimet e Fromm-it në realitetin kosovar, një nga sfidat më të mëdha për Kosovën do të ishte ndërtimi i një kulture demokratike dhe humane, ku qytetari nuk përcaktohet nga frika apo përkatësia grupore, por nga përgjegjësia personale dhe

mendimi i lirë. Ai do të kërkonte një sistem arsimor që zhvillon mendim kritik dhe etikë qytetare, si dhe institucione që krijojnë drejtësi sociale, besim publik dhe dinjitet njerëzor. Për Fromm-in, demokracia nuk mund të mbështetet vetëm në institucione formale; ajo mbijeton vetëm kur shoqëria zhvillon solidaritet, tolerancë dhe kulturë dialogu.

Në thelb, mesazhi i tij për Kosovën do të ishte se zhvillimi ekonomik dhe shtetëror nuk ka kuptim pa zhvillim njerëzor. Një shoqëri që humb humanizmin, empatinë dhe aftësinë për të menduar kritikisht rrezikon të mbetet e bllokuar në cikle konflikti, mosbesimi dhe zhgënjimi kolektiv. Prandaj, sipas Fromm-it, e ardhmja e Kosovës do të varej jo vetëm nga politika apo ekonomia, por nga aftësia e saj për të ndërtuar qytetarë të lirë shpirtërisht, të përgjegjshëm dhe solidarë me njëri-tjetrin.

Në përfundim, analiza e Erich Fromm-it mbetet shumë aktuale për të kuptuar sfidat e shoqërisë kosovare. Kriza nuk është vetëm ekonomike apo politike, por edhe psikologjike dhe morale. Pikërisht për këtë arsye, humanizmi i Fromm-it ofron jo vetëm kritikë ndaj realitetit modern, por edhe një vizion për një shoqëri më humane, më të lirë dhe më solidarizuese.

## KLGI në Ferizaj diskuton për draft-metodologjinë për monitorimin e të drejtave të fëmijëve në nivel lokal

FERIZAJ, 13 MAJ - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) mbajti të mërkurën takim të radhës rajonal në Ferizaj në kuadër të projektit “Avancimi i të drejtave të fëmijëve në nivel lokal”.

Takimi mbledhi zyrtarë komunalë për të drejtat e fëmijëve, përfaqësues të organizatave lokale dhe partnerë të projektit, me qëllim

të prezantimit dhe diskutimit të draft-metodologjisë për monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në nivel lokal.

Përmes diskutimeve dhe shkëmbimit të komenteve e rekomandimeve nga perspektiva komunale dhe ajo e shoqërisë civile u identifikuan elemente të rëndësishme që do të kontribuojnë në finalizimin

e metodologjisë dhe krijimin e indikatorëve të matshëm, të cilët reflektojnë gjendjen reale të zbatimit të të drejtave të fëmijëve në komunat e këtij rajoni.

Projekti zbatohet në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financohet nga Swedish International Development Cooperation Agency (Sida).



# ALBIN KURTHI KUR TË DOJË I PREKË 60 %!



Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

Kur morali dhe jomorali bëhen një: LDK-ja, e shtrirë për toke në zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025 e mbajti një kuvend oportunist, jo për të analizuar shkaqet dhe pasojat e këtij debakli pas së cilave do të adresohet përgjegjësia konkrete të vendimmarrësit përkatësisht të kryetarit i kësaj partie. Kuvendi u organizua për të blerë kohë për kryetarin dhe llaskuçet e tij, për të mbijetuar po kjo kategori që shumë pak ose aspak kanë kontribuar për LDK-në. Nuk është se LDK-ja nuk ka kapacitet dhe personalitete që e përfaqësojnë denjësisht trashëgimin kombëtare, politike, morale dhe profesionale por se oportunizmi doli "mbi përshesh"... Kujtim Shala, Hikmete Bajrami, Avdullah Hoti, Arben Gashi, Janina Imeri dhe Ermal Sadiku për bindjen time janë lokomotiva që mund ta nxjerr LDK-në nga moçali i oportunizmit dhe përshtatjes çdo "lideri" apo garniture. Agim Veliu u përjashtua pa asnjë arsye sikur që fituesi i dy mandateve për kryetar të Prishtinës, Përparim Rama, në Llap e njohim si "djali i Kadrushit" është në një sandviç jonormal; midis LDK-së dhe qeverisë autokrate të Albin Kurthit - Neronit të Kosovës. Përparim Rama u tregua i ndershëm me partitë që i ndihmuan të fitojë zgjedhjet, në veçanti me PDK-në me të cilët po bashkëqeveris dhe sidomos

me vlerat e luftës dhe pengjet e Burgut të Hagës. Ndonëse pa një background partiak, Përparim Rama u shndërrua në një personalitet karizmatik e që paraqet rrezik serioz për sigurinë politike dhe qëndrueshmërinë e postit për Lumin e Xhikës, mbijetuesin kryesor të Kuvendit të fundit të LDK-së. Në këto rrethana kur "zori të çon edhe në derë të hasmit .." LDK-ja e kërkon shpëtimin pikërisht te shkatërruesja e kësaj partie, Vojsa Osmani, e përzënë nga padroni i saj Albin Kurthi nga Zyra e Presidencës, e cila nuk la gjë pa bërë për të siguruar edhe një mandat! 100 për qind e nënshtruar ndaj diktatorit Kurthi, tash 100 për qind kundër diktatorit Kurthi. Ku është këtu morali, ma thoni lexues të nderuar?! Vojsa Osmani po vëzhgonte me kujdes zhvillimet në LDK duke ditur se po e konsiderojnë si "rrip sigurie" për të shpëtuar shoferin - politikanin amator, Lumin e Xhikës. Vojsa Osmani pa ndjenjën më të vogël të keqardhjes për demin që i ka shkaktuar LDK-së dhe Kosovës, triumfalisht u kthye në LDK, me fustanin e martesës politike me LV-në ndërkaq shoqëruesi i parë ishte pikërisht Lumi i Xhikës. I ndërruan rolet, Vojsa u bë njëshi, Lumi i Xhikës, nga njëshi u bë dyshi. Ky ishte edhe qëllimi që këta të dy të jenë përfituesit kryesor ndërsa diçka mbetet edhe për ata që ua mbajnë zhagun. Realisht, LDK-ja mund dhe do të rritet, mendoj te 20 për qind por se kjo qëndrueshmëri nuk do të jetë reale por artificiale. Ta shohim si do të lëvizin gjërat më vonë... Si do ta zhvillojnë fushatën. Duhet thënë qartazi se slogani: "Lumi i Xhikës i propozuar për KM dhe Vojsa Osmani për presidente" është mashtrim për faktin se

zgjedhjet nuk mbahen për president, Kosova nuk ka sistem presidencial. PDK-ja ka bërë mrekulli që nuk ka rënë shumë me vota përkundër goditjeve nga brenda dhe jashtë. Regjimi autokratik i Albin Kurthit, si "mik i Gjykatës Speciale Raciste në Hagë" ka bërë të mundurën dhe të pamundurën ta shkatërrojë këtë parti që, bashkë me AAK-në, një pjesë të LDK-së, individëve që tani janë në këtë parti (LV-së) kanë qenë palca e shtyllës kurriore të UÇK-së dhe luftës çlirimtare. Nga brenda PDK-ja po goditet nga mujsarë analfabetë dhe injorantë që janë veshur me pushtet të pamerituar e që në mungesë të liderëve të vërtetë, Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit po veshin lëkurat që as që iu takojnë e as që i meritojnë shkaku se i kanë ndërruar, jo sipas motit meteorologjik por sipas interesit puro politik. PDK-ja duhet të shkëputet nga disa "personalitete" nëse do ta "kalojë Rubikonin". PDK-ja aspak nuk dobësohet që nuk e futi në listë Fatmir Limajn, përkundrazi do të dobësohet po ta fuste në listë! Nuk di kush është në listën për deputetë të PDK-së por për mua është befasi e madhe futja e Rustem Mustafës - komandant Remit për faktin se kam qenë i sigurt se Remi do të jetë në 5-shin e parë të listës së LV-së gjykuar në qëndrimet politike dhe deklaratat në 4 vitet e fundit - më militant i LV-së deklarohet Remi se Mefail Bajçinovci! PDK-ja është dashur t'i largojë nga lista të gjithë ata që në vend të kutive të votimit kanë përdorur thasë për mbledhje - vjedhje të votave. PDK-ja dhe LDK-ja kanë potencialin më cilësorë të përfaqësimit politik nëse e bëjnë zgjedhjen e duhur. Deri më tani nuk shoh asnjë arsye që

PDK-ja të humbë vota, sepse ka një trup votues të qëndrueshëm. Jam i sigurt se AAK-ja e kalon pragun pa problem dhe se nuk mbetet nën 8 deputetë. Kalimi i pragut për PSD-në është vetëm: "një ëndërr e bukur e një dite vere .." Si të ikën ëndërra do të shohim një PSD me hundë të thyer që mori në thua në pragun zgjedhor. Është interesant se PSD-ja në këto zgjedhje nuk po hynë ta luftojë pozitën por opozitën! Vërtet rast sui generis! LV-ja do të bjerë në përqindje, sa vështirë të përcaktohet. Pas zgjedhjeve nuk do të jetë në gjendje ta formojë qeverinë pa bërë koalicion pa ndonjë parti tjetër e lëre më që Feriden dhe Hatixhen me shami të kuqe t'i bëjë presidentë! Opozita nuk duhet ta shajnë Albin Kurthin sepse është pajtuar me fytyrën. Morali politik dhe ndershmeria te Albini janë "persona non grata". Opozita duhet t'ia faturtojë Albin Kurthit dështimet ekonomike, mjerimin social, institucionalizimin e korrupsionit duke e shndërruar në aset që mbrohet nga shteti, kapjen dhe prostituimin e të gjitha posteve qeveritare dhe joqeveritare, dhunimin e luftës dhe vlerave të luftës, federalizimin e Kosovës përmes Marrëveshjes së Brukselit dhe aneksit të Ohrit, instalimit dhe funksionalizimit të udhësive në institucione, greqizimit të AKI-së dhe një pjese të Policisë përmes shartimit të dejonamihalizmit në këto dhe jo vetëm këto struktura. Albin Kurthi duhet të ballafaqohet me faktin se me çfarë morali i viziton dhe flet me "pasion patriotik" për familjet emblematike Jashari dhe Heradinaj ndërsa i ka afër, bashkëjeton, bashkëvepron, bashkëqeverisë dhe bashkës-

hkatërron me projugosllavët dhe antikombëtarët Surroi, Basha, Murati, Gashi, Gjinovci, Gjymshiti si dhe injorantët dhe llaskuçet, Halilaj, Shala, Maxharraj, Ramabaja, pozharët, agimbahtirët, lenkaqkukot, arbresha me krye të zi, adrianamatoshkat dhe të tjera, nga A deri më Zh. Opozita duhet ta përballë Kurthin me shkatërrimin e pozitës dhe identitetit shqiptar në Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Luginë të Preshevës. Këto koordinata të veprimit opozitar janë në vija të trasha, konkretizimi i tyre i përimtësuar do t'i siguronte opozitës së bashkuar një fitore të sigurt kurse Kurthit fitoren e Piroso - të trashë të Surlës. Opozita duhet ta ketë të qartë se pas këtyre zgjedhjeve nuk do të ketë zgjedhje tjera të shpejta dhe se mbi këtë fakt ta ndërtojë strategjinë e veprimit. Sqarim se si Kurthi mund t'i prekë 60 për qind të votave: Një politikan që në 51.1% të votave të fituara e çon vendin në zgjedhje të parakohshme nuk mund të konsiderohet si një fenomen politik, më shumë është rast për studim dhe trajtim klinik. Tash, po ky rast botërisht po deklarohet se në zgjedhjet e ardhshme mund ta prekë rezultatin prej 60 për qind. Plotësisht i besoj, shumë lehtë e realizon. Mjafton ta merr një copë letre apo pëlhure në të cilën do ta shkruante 60% dhe ta vendosë në zyrën e KM, në zyrën e Dejana Mihalit në Greqi, në zyrën e partisë - shtet LV-së dhe në shtëpinë ku banon dhe pastaj, kur të dojë ta prekë atë shifër me duar! Kështu mund ta prekë 60 përqindësin dhe ky do të jetë ngushëllim për të.....kur të bie nga fiku!

## BQK-ja DHE EUROSTAT-i VLERËSUAN PËRPARIMIN E ARRITUR NË PËRAFRIMIN E STATISTIKAVE KOMBËTARE ME STANDARDET EVROPIANE

PRISHTINË, 8 MAJ - Zëvendësguvernatori i BQK-së, Dardan Fusha, me kolegët nga Departamenti i Statistikave, priti një mision nga Eurostat, Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian, i fokusuar në shqyrtimin e përpimit në fushën e statistikave dhe në përafrimin e mëtejshëm me standardet statistikore evropiane. Delegacioni i Eurostat-it u udhëhoq nga Claudia Juncker, shefe e Njësisë për Zgjerim, Fqinjësi dhe Bashkëpunim për Zhvillim, si dhe nga Kari Anne Lund, zyrtare statistikore e sapoemëruar përgjegjëse për Kosovën. Misioni përfshinte gjithashtu Ibrahim Rustemin, drejtor i Departamentit për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK). Gjatë takimit

zëvendësguvernatori i BQK-së, Dardan Fusha, theksoi se statistikave mbeten një prioritet strategjik, duke pasur parasysh rëndësinë e tyre për hartimin e politikave, transparencën dhe procesin e integritimit evropian. Si BQK ashtu edhe Eurostat vlerësuan përpimitin e arritur në vitet e fundit në përafrimin e statistikave kombëtare me standardet evropiane, duke u mbështetur në bashkëpunimin afatgjatë të BQK-së me Eurostat-in përmes transmetimit të rregullt të të dhënave për më shumë se një dekadë. Përpimitin e veçantë u theksua në fusha kyçe si Bilanci i Pagesave, Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare, Investimet e Huaja Direkte (IHD) dhe statistikave të Tregtisë Ndërkombëtare në Shërbime (TNS). BQK paraqiti përpjekjet e saj të



vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe zgjerimin e mbulimit statistikor si dhe për forcimin e kornizave metodologjike. Këto përpjekje mbështeten nga aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve, angazhimin e stafit të ri dhe përpimitin e vazhdueshëm në automatizimin dhe modernizimin e proceseve statistikore. Në këtë kontekst, bashkëpunimi me ASK-në u

vlerësua shumë, me theks të veçantë në rëndësinë e koordinimit të fortë institucional për ta siguruar konsistencën e të dhënave, harmonizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit statistikor kombëtar. Në të njëjtën kohë, gjatë diskutimit u theksua nevoja për përpjekje të vazhdueshme për avancim të reformave në vijim, veçanërisht në forcimin e mbulimit të të dhënave, në

përmirësimin e mëtejshëm të statistikave të IHD-ve dhe në përpjektimin e kalimit nga fazat zhvillimore në zbatimin e plotë operacional të sistemeve dhe proceseve statistikore. BQK-ja ritheksoi përkushtimin e saj për përafrim të mëtejshëm me Eurostatin dhe standardet ndërkombëtare statistikore, duke përfshirë vazhdimin e punës drejt aderimit në Standardin Special të Shpërndarjes së të Dhënave (SDDS) të FMN-së, krahas modernizimit të vazhdueshëm të infrastrukturës statistikore. Banka Qendrore shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe udhëzimin e vazhdueshëm nga Eurostat, duke rikonfirmuar përkushtimin për bashkëpunim të ngushtë me Eurostatin dhe partnerët kombëtarë, përfshirë ASK-në, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete në periudhën e ardhshme.

# NJË RRJET MILIARDASH NË BALLKAN DHE NJË MUNGESË QË BIE NË SY: KOSOVA

**PRISHTINË, 13 MAJ** - Ndërsa gazi po kthehet në armën kryesore të sigurisë energjetike në Evropë, Shtetet e Bashkuara po shtyjnë fuqishëm projekte të reja në Ballkanin Perëndimor. Nga Shqipëria në Bosnjë-Hercegovinë, rrjeti i ri po merr formë. Por, në hartën e re që po krijohet, Kosova mungon. Në pesë vjetët e fundit qasja e Kosovës ndaj gazit ka qenë më shumë një "tërhqi e mos e këput" sesa një politikë e vendosur. Nga një projekt konkret me mbështetje amerikane, te refuzimi i tij në vitin 2021, e deri te rikthimi i diskutimeve për mundësi të reja këtë vit, vendi është ende pa një drejtim të qartë.

Në Samitin Trans-Atlantik për Sigurinë e Gazit, të mbajtur në shkurt në Uashington, ministria e Ekonomisë e Kosovës, Artane Rizvanolli, tani në detyrë, shprehu gatishmërinë e Kosovës për t'u furnizuar me gaz natyror nga Shtetet e Bashkuara, duke e përshkruar bashkëpunimin si "vendimtar" për një sektor të sigurt energjetik.

Për një vend si Kosova, ku rreth 90 për qind e energjisë elektrike prodhohet ende nga qymyri, dhe vetëm rreth 10 për qind vjen nga burime të ripërtërishme si uji, era dhe dielli, është fakt që gazi mund të shërbejë si alternativë për ta thyer varësinë e thellë nga një burim i vetëm.

Por, në javët e fundit, kur ShBA-ja dhe kompani amerikane kanë nënshkruar marrëveshje miliardëshe me disa vende të Ballkanit Perëndimor - për ta zgjeruar ndikimin energjetik në rajon - Kosova nuk ka qenë pjesë e kësaj vale investimesh.

Në iniciativë të rëndësishme kanë hyrë: Shqipëria, Kroacia dhe Bosnjë-Hercegovina, përfshirë edhe një projekt të madh për ndërtimin e një tubacioni gazi që synon ta shkëpusë Sarajevën nga furnizimet ruse.

Për sekretarin amerikan të Energjisë, Chris Wright, kjo nënkupton një epokë të re bashkëpunimi me Evropën Qendrore dhe Lindore. "Këto partneritete bazohen në mbështetjen tonë të ndërsjellë për një agjendë të zgjerimit energjetik - dhe kjo dëshmohet nga marrëveshjet me vlerë prej miliarda dollarësh, që janë nënshkruar", shkroi Wright në X. Edhe pse pa një rol të qartë në këto zhvillime, Kosova nuk është jashtë vëmendjes së Shteteve të Bashkuara. I dërguari i posaçëm i Departamentit Amerikan të Energjisë, Joshua Volz, thotë për Radion Evropa e Lirë se sistemi energjetik i Kosovës ka nevojë urgjente për modernizim - çfarë krijon mundësi të mëdha për industrinë amerikane që të investojë. Megjithatë, ai thekson se projektet e mëdha do të varen nga vetë Kosova, përkatësisht përmirësimi i mjedisit biznesor dhe rregullator në vend. "Duhet të

bëhen hapa për t'i nxitur investimet private amerikane dhe financimet ndërkombëtare që të vijnë në Kosovë. Për këtë po punojnë Departamenti i Tregtisë, Departamenti i Thesarit dhe Departamenti i Shtetit i ShBA-së. Nëse dhe kur dinamikat e tregut ndryshojnë dhe mjedisi i biznesit bëhet më tërheqës, Departamenti i Energjisë do të jetë i gatshëm të ndihmojë në ndërmjetësim mes industrisë amerikane dhe partnerëve industrialë në Kosovë", thotë Volz. Volz shpreh optimizëm dhe thekson se lidhja e Kosovës me infrastrukturën rajonale të gazit është tashmë pjesë e diskutimeve që po zhvillohen. "Qëllimi ynë është që burimet energjetike amerikane të arrijnë te të gjithë partnerët dhe aleatët tanë, që janë të interesuar për një bashkëpunim afatgjatë energjetik me industrinë amerikane dhe me Shtetet e Bashkuara", thotë ai.

Radio Evropa e Lirë pyeti Ministrinë e Ekonomisë së Kosovës nëse ekziston ndonjë plan apo afat konkret për lidhjen me rrjetin rajonal, për mundësitë e ndërtimit të infrastrukturës së gazit dhe për bisedimet me zyrtarët amerikanë, por nuk mori përgjigje as pas një jave pritjeje. Aktualisht Kosova përfiton nga programi Kompakt i Qeverisë amerikane me vlerë mbi 230 milionë euro, i cili është i fokusuar në energji të pastër dhe stabilitet të furnizimit. Si pjesë e tij, vendi tashmë ka siguruar bateri me kapacitet të lartë për ruajtjen e energjisë.

E ngarkuara me punë në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, Anu Prattipati, tha në një ngjarje këtë javë se ky investim është dizajnuar pikërisht për ta adresuar furnizimin e paqëndrueshëm me energji në Kosovë - një problem që prej vitesh ndikon negativisht në biznes, familje dhe konkurrencë. "Asnjë përparim nuk ndodh në izolim. Shtetet e Bashkuara e mbështesin Kosovën në këto përpjekje, por suksesi varet nga angazhimi i vazhdueshëm i Qeverisë së Kosovës, sektori privat, institucionet financiare dhe shoqëria civile", tha Prattipati. Pesë vjet më parë Kosova hoqi dorë nga projekti për ndërtimin e infrastrukturës së gazit, i financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit e ShBA-së. Atëkohë, ministria e Energjisë, Artane Rizvanolli, tha se "nevojiten më shumë informacione për të qenë të sigurt se ndërtimi i infrastrukturës së gazit është opsioni më i mirë për tranzicionin energjetik".

"Gazsjellësi do të bëhet nëse është në interes të qytetarëve dhe të shtetit të Kosovës dhe në përputhje me Strategjinë e Kosovës. Së pari bëhet Strategjia, pastaj merren vendime për projekte specifike", tha Rizvanolli në një seancë të Kuvendit, më 18



nëntor 2021.

Në Strategjinë që u bë për vitet 2022-2031 u parapa mundësia që Kosova të lidhet me rrjetet rajonale të gazit në të ardhmen, dhe që qymyri të hiqet nga përdorimi më së voni deri në vitin 2050, për t'u lënë vend burimeve të tjera energjetike. "(Bashkë)investimi në termocentralin me gaz natyror, për qëllim të mbulimit të kërkesës bazë dhe/ose për fleksibilitet të sistemit në Shqipëri, por edhe në Maqedoni të Veriut dhe në Greqi, do të shqyrtohet me qëllim të zbatimit brenda afatit të kësaj strategjie", thuhet në dokument. Kosova nuk ka dalje në det - gjë që e bën më të vështirë ndërtimin e infrastrukturës së gazit pa bashkëpunim me vendet fqinje. Një nga opsionet është lidhja me infrastrukturën e planifikuar në Shqipëri ose Greqi, veçanërisht përmes gazsjellësit TAP - që transporton gaz nga Azerbajxhani, përmes Greqisë dhe Shqipërisë, deri në Itali - ose përmes terminalit të gazit të lëngshëm në Vlorë.

Burim Ejupi, drejtor i Institutit për Politika Zhvillimore - Indep në Prishtinë, thotë se Kosova nuk e ka humbur plotësisht hapin, por se ka mbetur prapa, për shkak të mungesës së një qëndrimi të qartë politik. Ai thotë se, ndonëse gazi tashmë është afër - me infrastrukturën në Shqipëri dhe atë në Maqedoni të Veriut - vendi vazhdon të lëvizë pa një drejtim të prerë. "Mënyra më e lehtë e tranzicionit energjetik është përmes gazit, pasi, gjatë djegies, ai emeton rreth dy herë më pak dyoksid karboni. Po ashtu, termocentrali me gaz vihet në punë shumë shpejt dhe ka kapacitet të kontrolluar prodhimi. Kosova ka probleme edhe me balancimin e energjisë, ndaj një termocentrali me gaz do të ishte shumë i mirëseardhur, sidomos kur dihet se vitet e fundit po paguhen gjoba milionëshe për këtë arsye", thotë Ejupi për programin Expose të Radios Evropa e Lirë.

Një studim që publikoi Instituti Indep në vitin 2022 konstatoi se gazi natyror mund të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për

Kosovën në adresimin e së ashtuquajturës "trileme

energjetike" - dekarbonizimin, sigurinë e furnizimit dhe energjinë e përbalueshme.

Po atë vit u publikua edhe një studim i financuar nga Banka Evropiane për Investime, i cili theksonte se burimet finale të gazit natyror për Kosovën mund ta përfshijnë gazin rus, gazin e lëngshëm natyror nga Greqia, si dhe atë nga Kroacia.

Me ndryshimin e rrethanave gjeopolitike dhe zhvillimet e reja në terren, Ejupi thotë se gazi për Kosovën nuk është më çështje teknike, por e vendimmarrjes politike. "Në ish-Jugosllavi ka ekzistuar traseja prej Obiliqit deri në Shkup dhe prej Obiliqit deri në Mitrovicë. Në Obiliq ka qenë ngrohtorja, prej ku është dërguar avulli në Hekuranën e Shkupit, por gjithashtu edhe në Trepçë. Domethënë, sa i përket infrastrukturës tokësore, Kosova nuk ka nevojë për shpronësime, sepse tashmë ato ekzistojnë", thotë Ejupi.

Ai shton se, sipas disa llogaritjeve dhe duke marrë parasysh investimet në TAP, ndërtimi i plotë i infrastrukturës së gazit në Kosovë mund të realizohet për 3 deri në 5 vjet, me një kosto që varion nga rreth 200 milionë deri në 400 milionë euro. "Ne i kemi tri industri të mëdha aktualisht në Kosovë. Është Feronikeli, i cili është jashtë funksionit, është Trepça dhe Sharr-Cemi. Ato mund ta ndërrojnë sistemin e operimit prej energjisë elektrike në gaz", shprehet Ejupi.

Brenda Shaffer, nga Qendra Globale e Energjisë pranë Këshillit Atlantik, thotë se sfida kryesore në përgjithësi nuk qëndron te tubacionet apo interkonektorët, por te sigurimi i burimit kryesor të gazit. Dhe për Kosovën, sipas saj, ky burim tashmë ekziston - për shembull përmes Korridorit Jugor të Gazit nëpërmjet Shqipërisë.

Duke e trajtuar këtë si çështje politike dhe prioritete, e jo thjesht teknike, Shaffer thotë se nisma e mbështetur nga ShBA-ja për ndërlidhjet e gazit në Ballkanin Perëndimor përbën një mundësi historike për diversifikimin e furnizimeve me

energji dhe uljen e ndotjes. "Nëse nuk je i sigurt në aspektin energjetik, nuk mund të jesh i sigurt si shtet. Nuk ka siguri kombëtare pa siguri energjetike - nuk mund të mbrohesh, nuk mund të ndërtosh industri të armëve... Kjo ka qenë gjithmonë qasja e ShBA-së: t'i ndihmojë aleatët dhe partnerët të bëhen të sigurt në aspektin energjetik, sepse nëse aleatët e tu janë të sigurt, atëherë edhe ti je i sigurt", thotë Shaffer për Exposenë. Por, si çdo burim energjie, edhe gazi nuk shihet vetëm në një drejtim. Ai sjell përfitime, por edhe dilema dhe kosto.

Anne-Sophie Corbeau nga Qendra për Politikën Globale të Energjisë me seli në Paris thotë se Kosova nuk duhet domosdoshmërisht të orientohet drejt gazit. Sipas saj, kalimi nga qymyri te gazi nuk është zgjidhje automatike, pasi duhet peshuar rreziku i luhatjeve të tregut dhe mundësia që një varësi të zëvendësohet me një tjetër, në vend të një diversifikimi të vërtetë energjetik. "Ajo që po shoh është se i gjithë rajoni po kalon nga një varësi, që më parë ishte nga gazi rus, në një varësi tjetër që kryesisht lidhet me gazin e lëngshëm natyror amerikan. Të varësh nga ky gaz është në rregull, sepse mund të shfrytëzosh burime të ndryshme furnizimi. Por, nëse gjithçka vjen vetëm nga një vend i vetëm, edhe pse ai pritet të bëhet një eksportues shumë i madh i energjisë në të ardhmen, a do të doje të ishe i varur vetëm nga një shtet?", thotë Corbeau për Exposenë.

Ajo që është e sigurt, sipas zyrtarit të lartë të Departamentit Amerikan të Energjisë, Volz, është se vendet që zgjedhin të bashkëpunojnë me ShBA-në për sigurinë dhe diversifikimin energjetik, mund të presin rritje të investimeve të huaja, pasi prania amerikane në sektorin e energjisë shihet si një faktor stabiliteti dhe besueshmërie. Në këtë kontekst, gazifikimi mund të jetë pikërisht shtesa që i duhet Kosovës për të dalë nga pasiguria energjetike dhe për t'u bërë më tërheqëse për investimet.

# SI U KTHYE LUFTA ME IRANIN, NË AVANTAZH GJIGANT PËR KINËN



## Lufta me Iranin dhe ndihma (e pavullnetshme) për Kinën, që duhej të përfundonte në qoshe dhe tani po pushton tregjet “e gjelbëra”

Nga Federico FUBINI

Një nga objektivat e luftës ndaj Iranit që i atribuoheshin Donald Trumpit, ishte anashkalimi i Kinës në planin e burimeve strategjike. Në janar, presidenti i Shteteve të Bashkuara, me kapjen e Nicolás Maduros, kishte marrë kontrollin e naftës venezueliane, duke ndërprerë furnizimet për superfuqinë rivale. Ndryshimi i regjimit në Iran duhej ta shumëfishonte atë efekt, në teori.

Por tani po fillon të shfaqet një përmbysje rolesh: tronditja energjetike që pasoi bllokimin e Hormuzit po bën të shpërthejë

kërkesa ndërkombëtare për teknologji të gjelbra të prodhuara në Kinë.

Lufta kundër ndryshimeve klimatike nuk është rikthyer në krye të listës së objektivave të shumicës së qeverive të planetit. Në vend të saj, në krye është ngjitur gara për autonomi strategjike, me uljen e varësisë nga nafta dhe gazi i importuar. Kështu, të dhënat mbi eksportin e paneleve diellore kineze drejt pjesës tjetër të botës në mars, muaji i parë i luftës mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit, tregojnë një dyfishim të shitjeve të moduleve të gatshme: nga një kapacitet prej 16 gigavatësh në 31, sipas qendrës kërkimore

Ember, që bazohet në të dhënat doganore kineze.

Nëse shihen edhe komponentët e paneleve, si qelizat dhe waferat, Kina në mars i ka shitur botës ekuivalentin e fuqisë së instaluar fotovoltaike të gjithë Spanjës: 68 gigavatë, një nivel 50% më i lartë se çdo rekord i mëparshëm historik.

Republika Popullore nuk është thjesht lider në industrinë fotovoltaike: praktikisht është zotëruesja e pakontestueshme e saj. Sipas Center for Strategic and International Studies, ajo kontrollon shumë më tepër se nëntë të dhjetat e prodhimit global të wafer-ave të silikonit dhe qelizave fotovoltaike, ndërsa pjesa e saj në panelet e

gatshme arrin rreth 86%.

Për çdo vend, forcimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme do të thotë, në masë të madhe, të blesh nga Kina. Po e bën, shumë më tepër se më parë, edhe Italia. Midis shkurtit dhe marsit, blerjet italiane të paneleve nga Kina janë më shumë se dyfishuar, në nivelet më të larta historike, nga një kapacitet prej 0.28 gigavatësh në 0.61 gigavatë.

I njëjti efekt i Hormuzit shihet edhe te makinat. Në Bashkimin Evropian, në mars, pjesa e shitjeve të modeleve të reja elektrike, një tjetër sektor ku dominojnë prodhuesit kinezë, për herë të parë pothuajse barazohet me makinat me benzinë. Në Gjermani (24% e regjistrimeve të reja) dhe në France (28%), ky parakalim tashmë është realitet.

Në nivel evropian, gjithmonë në mars, rritja e shitjeve të modeleve elektrike është rreth 50% më e lartë krahasuar me një vit më parë. Italia shënon rritjen më të fortë, por nga nivele ende


shumë poshtë mesatares europiane dhe nën shtysën e incentiva publike specifike.

Në vitet '70, dy goditjet e naftës përshpejtuan një tranzicion industrial që favorizoi prodhues si Fiat: konsumatorët kaluan nga sedanët e mëdhenj te makinat e vogla me konsum të ulët. Sot, goditja e lidhur me Hormuzin po shpërblen pothuajse vetëm Kinën.

Sipas të dhënave të saj doganore, rritja e eksporteve të Republikës Popullore drejt Italisë dhe Gjermanisë, në dollarë, është më shumë se një e katërta krahasuar me një vit më parë. Kështu po konsumohet heterogjeneza e qëllimeve të Donald Trumpit. Ai duhej t'i priste Pekinit aksesin në burime strategjike. Në vend të kësaj, i ka dhënë Xi Jinpingut një nga asistet më të pabesueshme dhe më fatlume në historinë industriale.

Duhej të ndiqte politikën e “drill, baby, drill”, shpim dhe nxjerrje naftë. Në vend të kësaj, ka ulur oreksin botëror për naftë.

Corriere della Sera – Bota.al



## NJË DEKADË NGA ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË FIFA

**PRISHTINË, 13 MAJ** - Para dhjetë vjetësh Kosova është bërë anëtarja e 210 e FIFA-s. Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) kishte marrë 141 vota për anëtarësim, nga 164 votat e vlefshme në Kongresin e 66 të FIFA-s që ishte mbajtur në Meksiko City. Pas thyerjes së izolimit 25-vjeçar më 3 maj 2016 me anëtarësim në UEFA, misioni i Federatës së Futbollit të Kosovës ishte kompletuar më 13 maj 2016, kur Kosova është pranuar me shumicë votash si anëtare e FIFA-s. Një rrugëtim plot mund e sakrificat që

gjithsesi hapi një faqe të re të historisë së futbollit të Kosovës. Në Kongresin e FIFA-s, para votimit për anëtarësimin e FFK-së, të pranishmëve u ishte drejtuar anëtari i Këshillit të FIFA-s, Senesh Erzik, i cili kishte theksuar se Kosova i kishte përmbushur të gjitha kriteret për të qenë pjesë e FIFA-s.

Më pas një fjalim e kishte mbajtur edhe presidenti i atëhershëm i FFK-së, i ndjeri Fadil Vokrri, i cili ua pati sqaruar delegatëve se futbollit në Kosovë ka një historik të madh dhe ua kujtuar se



tashmë Kosova ishte pranuar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar dhe nga shumë federata të tjera sportive ndërkombëtare. Në fund të fjalimit të tij, Vokrri kishte thënë se futbollit është për të gjithë dhe të gjithë duhet

të jenë për futbollin, duke kërkuar që Kosova t'i marrë votat e të pranishmëve për anëtarësim në FIFA.

Pas Vokrrit, delegatëve u ishte drejtuar nënkryetari i Federatës së Futbollit të Serbisë, i cili pati kundërshtuar anëtarësimin e Kosovës, por pas përfundimit të fjalimit të tij, presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, kishte theksuar se Kongresi është trupi suprem që vendos për çështjen e Kosovës, duke kërkuar që të kalohet në votimin elektronik, ku Kosova pati marrë 141 vota.

Në fjalimin e tij para Kongresit

pas pranimit, Vokrri kishte falënderuar presidentin e FIFA-s, zëvendëspresidentët dhe të gjithë anëtarët e Këshillit të FIFA-s. "Kjo është një datë shumë e rëndësishme për ne, pasi sot jemi pjesë e FIFA-s. Të gjithë në Kosovë i gëzohen këtij vendimi të Kongresit të FIFA-s. E kemi pritur një kohë të gjatë këtë vendim dhe jemi shumë të lumtur. Ju premtoj se ne do t'i mbrojmë vlerat e futbollit", pati deklaruar Vokrri, i cili në mënyrë simbolike mori emblemën e FIFA-s si dhuratë nga presidenti Infantino.

## ADEMI: PRANIMI I KOSOVËS NË FIFA ISHTE FILLIMI I NJË EPOKE TË RE

Me rastin e shënimit të 10-vjetorit të pranimit të Kosovës në FIFA, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka thënë pranimit i vendit tonë në shtëpinë më të madhe të futbollit botëror është moment historik. "Sot shënojmë me krenari 10-vjetorin e anëtarësimin të Kosovës në FIFA, një moment historik ku FFK u bë anëtarja e 210 e shtëpisë më të madhe të

futbollit botëror. Ky ishte një triumf i madh për futbollin dhe shtetin tonë, pas një rrugë të gjatë sakrificash, përkushtimi dhe besimi të palëkundur. Ishte fitore e të gjitha gjeneratave që mbajtën gjallë futbollin e Kosovës edhe në periudhat më të vështira", ka thënë Ademi, duke shprehur mirënjohje për legjendën Fadil Vokrri dhe presidentin e FIFA-s, Gianni

Infantino. "Në këtë përvjetor jubilar, me respektin dhe mirënjohjen më të thellë kujtojmë legjendën Fadil Vokrri dhe të gjithë ata që dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në këtë rrugëtim historik. Mirënjohje e veçantë edhe për presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino, për mbështetjen dhe miqësinë e vazhdueshme ndaj Kosovës dhe futbollit tonë.



Pranimit në FIFA ishte fillimi i një epoke të re. Sot FFK është një institucion modern, me infrastrukturë në zhvillim të vazhdueshëm dhe me ekipet kombëtare e klubet tona që përfaqësojnë me dinjitet Kosovën në arenën ndërkombëtare. Vazhdojmë përpara me krenari dhe përgjegjësi, me futbollin për Kosovën!", ka thënë Ademi.

## RAMA PËR LOJËRAT MESDHETARE: MUNDËSI QË VJEN VETËM NJË HERË NË JETË

**PRISHTINË, 13 MAJ** - Organizimi i Lojërave Mesdhetare 2030 në Prishtinë po konsiderohet si një ndër projektet më të mëdha sportive dhe zhvillimore për Kosovën, me ndikim të drejtpërdrejtë jo vetëm në sport, por edhe në infrastrukturë, ekonomi dhe imazh ndërkombëtar. Institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë tashmë kanë nisur përgatitjet dhe koordinimin, duke e parë këtë ngjarje si një mundësi unike për vendin që të paraqitet në arenën globale dhe të lërë një trashëgimi afatgjatë. Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka theksuar rëndësinë e përkushtimit dhe bashkëpunimit institucional për realizimin e këtij projekti



madhor. Ai ka vënë në pah se organizimi i Lojërave Mesdhetare kërkon kohë, përpjekje të mëdha dhe, mbi të gjitha, unitet mes nivelit lokal, qendror dhe institucioneve sportive, duke e cilësuar këtë si një mundësi që vjen vetëm një herë në jetë dhe që duhet shfrytëzuar për ta dëshmuar përparimin e vendit. "Ne po përgatitemi për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Mendoj se

ishte e rëndësishme që i gjithë ekipi ta shihte se kjo kërkon shumë përpjekje, kërkon kohë, mbi të gjitha kërkon unitet që ne duhet të punojmë së bashku, qeveria lokale, qeveria qendrore, si dhe Komiteti Olimpik, për t'i organizuar këto Lojëra, sepse ato mund të vijnë vetëm një herë në jetën tonë. Dhe ne duhet ta shfrytëzojmë këtë mundësi për të shkëlqyer dhe për të treguar se sa shumë ka përparuar vendi ynë. Prandaj do të jemi gjithmonë mirënjohës dhe le të vazhdojmë të bashkëpunojmë pavarësisht prej sfidave që kemi me qeverinë qendrore. Por komuna vazhdon të punojë dhe do të ecë përpara", ka thënë Rama në një ceremoni ku Komuna e Prishtinës dhe Ambasada e Mbretërisë së

Bashkuar në Kosovë kanë nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit në mbështetje të prestigjioze "Chevening".

Ndërsa ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, ka folur për rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përvojat që mund të përfitohen nga organizimi i ngjarjeve të ngjashme. Ai ka thënë se takimet me kompani britanike dhe shkëmbimi i përvojave janë të rëndësishme për përgatitjet, ndërsa nënvizoi potencialin që Prishtina dhe Kosova kanë për t'u paraqitur si një vend dinamik, me të rinj dhe mundësi zhvillimi, duke vënë theksin edhe te trashëgimia afatgjatë që këto lojëra mund të lënë pas.

Ndryshe, përgatitjet për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030 kanë marrë një shtysë të re edhe në aspektin institucional. Së fundi, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin e veçantë për organizimin e Lojërave Mesdhetare, duke krijuar bazën ligjore për financimin, ndërtimin e infrastrukturës dhe koordinimin ndërinstitucional. Ky hap konsiderohet kyç për mbarëvajtjen e projektit, pasi përcakton përgjegjësitë e institucioneve dhe garanton mbështetje të qëndrueshme shtetërore deri në vitin 2030. Në këtë mënyrë, Kosova po synon jo vetëm organizimin e suksesshëm të një eventi të madh sportiv ndërkombëtar, por edhe ndërtimin e një trashëgimie afatgjatë në sport dhe zhvillim urban.

## Aro Muriq largohet nga Sassuolo

Portieri i Kosovës, Arijanet Muriq, i cili ishte huazuar nga Ipswichi te Sassuolo në verën e vitit 2025 me një opsion blerjeje të vendosur për rreth 10 milionë euro, ka bërë me

dije se nuk do të luaj më për klubin italian. "Nuk kam ndër mend të luaj për Sasuolon sezonin e ardhshëm. Me përfundimin e huazimit tim, koha ime këtu ka mbaruar. E

kam informuar klubin se nuk dua të qëndroj këtu pas këtij sezoni për arsye personale", ka thënë ai "GianlucaDiMarzio". Muriqi ka luajtur vazhdimisht

këtë sezon, duke u paraqitur në 32 ndeshje, duke mbajtur portën e paprekur në gjashtë ndeshje. Portieri 27-vjeçar ka kontratë me Ipswichin deri në verën e vitit 2028.





## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Pozita:</b>	Zyrtar/e për Hulumtime dhe Analiza Ekonomike
<b>Grada:</b>	P06
<b>Kohëzgjatja e punësimit:</b>	Me afat të pacaktuar
<b>Departamenti:</b>	Departamenti i Stabilitetit Financiar, Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike
<b>Divizioni:</b>	Divizioni i Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike
<b>I raporton:</b>	Udhëheqësit të Divizionit të Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike

